E enjte, 11 korrik 2024

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

--- Seanca fillon në orën 09.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ju faleminderit, të nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në sallën e gjyqit. Do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit të Prokurorisë 04752.

Znj. Asistente, ju lutem silleni në sallë dëshmitarin.

Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a t'i përgjigjem pyetjes që m'u bë dje sa i takon kompjuterit?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull, mendova se do të dorëzonit diçka me shkrim, megjithatë mund të vazhdoni dhe mund të jepni parashtrimet tuaja.

Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës. Faleminderit që më dhatë mundësinë. Sikurse e dini, në këtë proces gjyqësor shumë dokumente janë ofruar për t'u pranuar në prova që Prokuroria pretendon që i ka gjetur në vendin e punës, në kompjuterin e z. Krasniqi, në shtëpinë e tij.

Sa i takon "vendit të punës", ose kompjuterit, atëherë thjesht sa për ta shpjeguar ne po flasim, e kuptojmë këtë, domethënë, sikur është një vend pune kompjuter. Një njësi kompjuterike. Me emailin e datës 28 qershor të këtij viti, Prokurori konfirmoi që ai nuk ishte i lidhur me një monitor, por ishte i lidhur me energjinë ose me rrymën elektrike. Megjithatë, ne e kuptojmë që kjo nuk është mënyra e punës dhe ai është përdorur si një mjet për mbështetje dhe ku vendoseshin rroba në mënyrë të tillë që të thaheshin dhe nuk është përdorur si vend pune.

Ndërkohë që sipas parashtrimit të Prokurorisë, parashtrohet që z. Krasniqi ka pas njohuri për autorësinë e këtyre dokumenteve.

Pozicioni ose qëndrimi ynë dhe sqarimet tona sa i takon kundërshtimeve të pranimit të këtyre dokumenteve që e kemi dhënë në parashtrimin tonë me numër 1387 është që Prokuroria duhet që të provojë këto pretendime. Dhe ka disa pengesa të cilat duhet të sqarojmë prej jush, të nderuar Gjykatës. Sepse Prokuroria nuk ka përcaktuar, ose nuk ka sqaruar se cila është, cili është zinxhiri i ruajtjes. Nuk kanë vërtetuar gjithashtu që kanë sekuestruar vendin e punës ose kompjuterin që i takon, që lidhet me fotografitë të cilat janë treguar dhe që pretendohet që të jenë bërë në shtëpinë e bardhë në Divjakë.

Dhe nuk është treguar se sa veta kanë pasur qasje në

kompjuter në periudhën nga 1999 deri në nëntor të 2020, edhe nuk është vërtetuar se z. Krasniqi ka përdorur apo jo kompjuterin fare. Po ashtu, nuk është vërtetuar në qoftë se dokumentet elektronike nuk janë larguar ose nuk janë marrë asnjëherë nga kompjuteri, në periudhën nga 1998 ose 1999, ose në qoftë se kanë mbetur si një version në draft ose version i papërfunduar.

Kështu që, si rezultat nuk mund të arrihet një përfundim sa i takon autorësisë apo njohurisë. Kështu që prova që një gamë njerëzish kanë pas qasje në atë kompjuter, në të vërtetë nuk mund të provojë që ndonjë person i caktuar i ka shtypur dokumentet ose në fakt në qoftë se këto dokumente në kompjuter kanë qenë dokumente për të cilat z. Krasniqi ka pasur dijeni apo jo.

Sa i takon kundërshtimit që ne vazhdojmë që të kemi, është që kundërshtimi ynë që Prokuroria nuk provon dot që dokumentet janë të besueshme ose autentike. Shumë dokumente janë paraqitur dëshmitarëve në këtë proces gjyqësor si dokumente të cilat janë sekuestruar nga Jakup Krasniqi, pa specifikuar që janë dokumente elektronike nga kompjuteri. Dëshmitarët, pjesa dërrmuese e tyre kanë thënë që është pjesa, hera e parë që i kanë parë këto dokumente, kështu që qëndrimi ynë është që nuk ka arsye të mjaftueshme për të treguar autenticitetin e dokumenteve.

Qëndrimi ynë është që Prokuroria duhet që të ketë provë

strikte për të gjitha këto çështje. Barra e provës i takon Prokurorisë.

Sa i takon çështjes faktike që ne po eksplorojmë në kundërpyetje, në qoftë se Prokuroria është e përgatitur që të tërhiqet si rezultat i mosvërtetimit të autorësisë ose njohurive për sa i takon dokumenteve, sigurisht që mund të kalojmë më shpejt për çështje të tjera në kundërpyetje. Por përderisa kjo mbetet ende pozicioni, ky mbetet ende pozicioni i Prokurorisë dhe në qoftë se Prokuroria nuk do të tërhiqet nga pozicioni i saj, sigurisht që ne do të bëjmë pyetje të cilat lidhen me këtë sferë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit shumë. Nuk e di në qoftë se Prokurori dëshiron që t'i përgjigjet. Ndoshta do të ishte mirë që t'i përgjigjeni të hënën përpara se të vijojmë me procesin.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund të përgjigjem shkurtimisht tani ose të hënën, si të doni ju.

Sigurisht që disa dokumente janë gjetur në posedim të z. Krasniqi, dhe në atë çfarë mendohet që ka qenë një aparat ose një kompjuter që është përdorur në atë kohë, ne mendojmë që është relevante dhe shton vlerë provuese sa i takon njohurisë së të akuzuarit për këto materiale.

Megjithatë, zakonisht ky është një faktor ndërmjet shumë faktorëve të tjerë, duke përfshirë këtu, për shembull marrëdhënien ndërmjet dokumenteve të gjetura në kompjuter dhe

dokumenteve të tjera të cilat janë gjetur në version të shtypur në posedimin e z. Krasniqi. Po ashtu, edhe pranimet e mëparshme të autorësisë nga z. Krasniqi të dokumenteve të caktuara, si edhe dëshmia nga dëshmitarë të caktuar besojmë që janë të mjaftueshme për të mbështetur pretendimin tonë.

Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

I lutem Asistentes ta sjellë dëshmitarin tani në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, më lejoni që t'ju rikujtoj dhe një herë që duhet t'i përgjigjeni pyetjeve me fjali të shkurtra, dhe qartazi. Në qoftë se nuk e kuptoni një pyetje, lirisht mund t'i kërkoni Avokatit që t'jua përsërisë ehe një herë apo t'jua shpjegojë më tej pyetjen. Po ashtu, mundohuni që të jepni bazën e njohurive, fakteve, dhe rrethanave për të cilat do të pyeteni.

Po ashtu, flisni afër mikrofonit, bëni një pauzë prej pesë sekondash përpara se sa t'i jepni përgjigje pyetjes, pastaj flisni me një ritëm të ngadaltë në mënyrë të tillë që t'ju kapin përkthyesit. Nëse e keni të nevojshme të bëhen pushime, ju lutem na e thoni këtë gjë dhe ne të bëjmë organizimet e nevojshme.

Po ju them dhe njëherë që jeni nën detyrimin për të

treguar të vërtetën, siç e keni deklaruar në deklaratën solemne të lexuar në fillim të procesit gjyqësor.

Sikurse ju thatë edhe javën e më përpara, nuk ju kërkohet që të jepni përgjigje në një pyetje që mund t'ju inkriminojë ju, me përjashtim të rasteve kur Trupi Gjykues ju detyron për ta bërë këtë gjë. Keni gjithashtu edhe Avokatin Mbrojtës në dispozicion i cili mund t'ju vijë në ndihmë në qoftë se lind nevoja për t'iu përgjigjur një pyetjeje që mund t'ju inkriminojë ju, Dëshmitar.

Tani, do të vazhdojë z. Alagendra me pyetjet e veta.

Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më lejoni, shumë shkurtimisht dëshiroj që të bëhet një korrigjim në transkript. Faqja 3, rreshti 22. Aktualisht në transkript thuhet "autentikojnë mjaftueshëm", në fakt unë thashë të kundërtën, thashë që "nuk janë mjaftueshmërisht autentikuese" këto dokumente.

DËSHMITARI: BISLIM ZYRAPI [Vijon]

Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra: [Vazhdim]

PY. Mirëmëngjes, z. Zyrapi.
PË. Mirëmëngjesi.
PY. Dëshiroj t'ju bëj disa pyetje që kanë të bëjnë me drejtorinë e operacioneve, ose drejtorinë operative.

Ju thatë që Sali Veseli dhe Naim Luku [Sipas përkthimit] kanë qenë pjesë e drejtorisë operative, a e thatë këtë gjë

dje, ju kujtohet kjo, Dëshmitar?
PË. Po.
PY. Sali Veseli ka qenë ish-oficer ushtarak, koleg i juaji në akademinë ushtarake, dhe në armatën jugosllave, kështu?
PË. Po.
PY. Po ashtu ai ka qenë zëvendësi juaj në drejtorinë operative, apo jo?
PË. Po, saktë.
PY. Naim Maloku është po ashtu ish-oficer ushtarak dhe ka qenë pjesë e drejtorisë operative deri sa është kthyer mbrapsht në zonën e Dukagjinit në fund të janarit 1999, a është e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Po, e saktë.
PY. Ju përmendët dhe Safet Shulën dje që thatë që ka qenë në të njëjtën ndërtesë që keni qenë dhe ju, apo jo?
PË. Po.
PY. Edhe ai ka ndjekur akademinë ushtarake dhe ka qenë ish-oficer i armatës jugosllave, a është kështu, Dëshmitar?
PË. Po, e saktë. Po, e saktë.
PY. Në seancën përgatitore me Prokurorinë, dhe kjo jepet në pikën 39 të Shënimit përgatitor numër 2, i keni thënë Prokurorisë që për drejtorinë operative ju keni kërkuar persona që kishin aftësi të ndryshme brenda ushtrisë dhe që kishin përvojë të mjaftueshme për t'u kyçur ose për t'u bërë pjesë e drejtorisë. A ju kujtohet ta keni thënë këtë,

Dëshmitar?
PË. Po, saktë.
PY. Është e vërtetë, apo jo, Dëshmitar, që juve ju duheshin njerëz me përvojë ushtarake në mënyrë të tillë që të kishin mundësi që të kryenin funksionet dhe përgjegjësitë e drejtorisë operative. Është e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Po, saktë.
PY. Tani dëshiroj që të kalojmë tek detyrat e drejtorisë operative.
Në Pjesën 7, në faqen 8 të intervistës që i keni dhënë ZPS-së në 2019, thoni që detyrat e drejtorisë operative përfshinin sulme ushtarake, fronte mbrojtje, përgatitje, trajnime, stërvitje, dhe përmirësimin profesional të ushtrisë. A është e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Po, saktë.
PY. Përveç këtyre përgjegjësive, keni thënë gjithashtu që detyrat e drejtorisë operative ishin riorganizimi i ushtrisë dhe ristrukturimi i saj. A është e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Po, e saktë.
PY. Tani dëshiroj që të përqendrohemi në dy pika tek sulmi dhe mbrojtja. Këto janë detyra rreptësisht ushtarake, apo jo, Dëshmitar?
PË. Po.
PY. Dhe drejtoria operative po përpiqej që të bashkërendonte përpjekjet e ushtarëve të UÇK-së për të shtrirë ose për të

zgjeruar zonat e kontrolluara nga UÇK-ja dhe për të mbrojtur pozicionet e veta, për të mbrojtur popullatën civile nga sulmet nga forcat serbe. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

PË. Po, ndër dhe ato detyra.

PY. A pajtoheni me mua që këto detyra kërkonin njohuri të konsiderueshme mbi taktikat dhe strategjitë ushtarake, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

PË. Po, e saktë.

PY. Tani të kalojmë tek pika e përgatitjeve. Përgatitja nuk kishte të bënte vetëm me trajnimin e ushtrisë, por kishte të bënte edhe me një farë niveli logjistike, apo jo, Dëshmitar?

PË. Po, përveçse trajnimeve të ushtarëve e eprorëve, është edhe normalisht logjistika. Por logjistika është në aspektin që planifikon ajo çka duhet të ketë, por jo, nuk mirret me logjistikë drejtoria operative.

PY. Përgatitjet përfshinin për shembull sigurimin e furnizimit të rregullt me uniforma, me armë dhe me pajisje të tjera ushtarake, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

PË. Kjo është në përgatit, kur të them përgatitet në atë drejtim, unë, planifikon, drejtoria operative, këto i siguron logjistika.

PY. Dhe për të vlerësuar se çfarë armësh nevojiten për operacione të caktuara dhe në qoftë se ushtarët e UÇK-së janë pajisur apo jo siç duhet, ju besoj pajtoheni me mua që dikush duhet të ketë përvojë sa i takon taktikave ushtarake, a është

e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Po, e saktë.
PY. Përmendët përmirësimin profesional të ushtrisë dhe strukturës së vet dhe keni thënë që kjo bie nën përgjegjësitë e drejtorisë operative. Kur jeni kyçur në Shtabin e Përgjithshëm ju keni qenë oficer për zhvillimin dhe profesionalizimin e UÇK-së brenda drejtorisë operative. A është e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Po, e saktë.
PY. Ishte e rëndësishme për UÇK-në që të kishte profesionistë në radhët e veta, në mënyrë të tillë që këta profesionistë ta organizonin, të ndihmonin për organizimin e UÇK-së. A është e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Po.
PY. Për këtë arsye, ish-oficerë, dhe ju veçanërisht, vlerësoheshit dhe njihej kontributi juaj në UÇK, domethënë kishit një vlerësim të posaçëm brenda UÇK-së. A është e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Po.
PY. E di që keni thënë në seancën përgatitore, nuk e di në qoftë se ka qenë apo jo në seancën përgatitore apo në deklaratën që i keni dhënë Prokurorisë. Megjithatë, pavarësisht kësaj, keni thënë që nuk e keni lexuar librin e Jakup Krasniqit, “Kthesa e madhe”. A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet që të përgjigjeni "po" ose "jo", Dëshmitar.

DËSHMITARI: Po, po pres deri ta përfundon për me i dhanë përgjigje. Po, po. Nuk e kam lexu.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

PY. Në rregull. Do t'ju lexoj një pjesë të librit, për Sekretarinë jepet në faqen U015-8831. Aty thuhet:

"Kjo është bërë pas mbërritjes së Agim Qelajt dhe Bislim Zyrapit, të dy të cilët bënë kontribute të jashtëzakonshme për krijimin e formacioneve të rregullta të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës."

Pra, kontributet tuaja ishin të vyera, z. Zyrapi, apo jo?

PË. Po, aq sa kemi mujt t'i japim në atë kohë.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të paraqesë në ekran tani dokumentin SPOE00226468. Dokumentin e kemi tani në ekran.

PY. Këtë dokument jua tregoi z. Roberts dje. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

PË. Po, më kujtohet.

PY. Duket sikur ky është rendi i ditës i një takimi që mban datën 5 janar 1999. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

PË. Po, e saktë.

PY. Ju konfirmuat që, që prej 5, domethënë më 5 janar 1999 kjo drejtori nuk ishte funksionale. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

PË. Më falni, cila drejtori? Të jemi pak të saktë.

PY. Në rregull. Do t'i kalojmë njëra pas tjetrës. Tani, shikoni pak mesin e faqes. Në të thuhet:

"…. /Drejtoria/ logjistike duhet të fillojë që të funksionojë, duhet që të caktohet kryeshefi dhe zëvendës kryeshefi i drejtorisë së financave."

Nuk e di, e shikoni?

PË. Po, po e shikoj tash.

PY. Dhe pastaj më poshtë domethënë në fillim, sipër është:

"... duhet të funksionojë drejtoria e logjistikës dhe duhet të caktohet kryeshefi i DL-së."

Pastaj është:

"Kryeshefi dhe zëvendës kryeshefi i drejtorisë së financave."

A i lexoni këto, Dëshmitar? A është e saktë kjo që lexova?

PË. Po. Po e lexoj.

PY. Dhe më pas thuhet:

"Të caktohet kryeshefi dhe zëvendësuesi i drejtorisë së informimit publik."

E lexoni këtë, Dëshmitar?

PË. Po.

PY. I takon që më 5 janar 1999, të paktën tre drejtori nuk kishin as shef ose kryeshef, siç e quani juve, dhe nuk kishin as staf. Kështu, apo jo?

PË. Nuk është ashtu, të gjitha. Po, është e vërtetë drejtoria e logjistikës nuk ka pas, jo veç është q'atë kohë kur nuk është diskutu në këtë mbledhje, por edhe më vonë. Kurse drejtoria e financave ka qenë kryeshefi, faktikisht, drejtori i saj. Ka qenë Lahi Brahimi, qysh nga 1998. Por, po zëvendës masanej nuk e di kush u përcaktu.

Ajo që i përket informimit publik është e vërtetë se tash është dikund në këtë kohë, është përcaktue Berat Luzha më duket, që ka qenë drejtori i kësaj drejtorie. Në atë kohë që është përcaktu për me qenë, deri atëherë s'ka qenë.

PY. Në qoftë se lexojmë më sipër, thuhet që:

"Drejtoria operative duhet të kompletohet me më tepër staf."

Domethënë, a është e saktë që drejtoria operative nuk kishte plotësisht, nuk e kishte stafin e plotë me datë 5 janar 1999, Dëshmitar?

PË. Po, saktë.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit tani të kalojë në faqen SPOE00226470. Është i njëjti dokument, po një faqe tjetër.

PY. Duket sikur këto janë procesverbal i një takimi të mbajtur më datë 14 janar 1999, Dëshmitar. Kështu duket, apo jo?

PË. Po.

PY. Kjo i takon që të jetë diku dy muaj pas ushtrimit

ristrukturues në nëntor të 1998, domethënë mbas ristrukturimit që u përpoqët që të bënit, i takon që të kishte kaluar dy muaj deri në këtë datë, kështu, Dëshmitar?
PË. Po, saktë.
PY. Dhe i takon që ka një pauzë prej dhjetë ditësh nga takimi i mëparshëm. Domethënë, ishte takimi i datës 5, tani kemi takimin e datës 14, kështu i takon, domethënë, apo jo, Dëshmitar?
PË. Po.
PY. Përsëri, në qoftë se do lexoni pikën 2, thuhet:
"Puna e drejtorive dhe plotësimi me kuadro."
A e shikoni këtë pikë, Dëshmitar?
PË. Po. Po.
PY. Më poshtë është një tjetër numër 2, dhe lexohet:
"... Drejtoria e /Shërbimit Informativ/ duhet të plotësohet shumë urgjent dhe të shtrihet rrjeti informativ."
E lexoni këtë, Dëshmitar?
PË. Po. Po, e lexoj.
PY. Ju kërkoj ndjesë që flas shumë shpejt, edhe ka mbivendosje ndërmjet meje dhe dëshmitarit. Atëherë, domethënë pak më tepër se sa dy muaj pas përpjekjeve për riorganizim nga Shtabi i Përgjithshëm kishte ende drejtori pa kryeshefa, ose pa drejtorë. Kjo sugjerohet nga ky dokument. A do pajtoheshit me këtë, Dëshmitar?
PË. Po. Pajtohena çka i përket kësaj drejtorie në atë kohë,

për shkak se z. Veseli nuk ka qenë mbrenda, dhe nuk ka pas njerëz të merren, kush ta riorganizon, rregullon edhe mirret me këtë drejtori. Është e vërtetë, saktë.

PY. Kalojmë tek pika tjetër që ka të bëjë me drejtorinë e personelit, thuhet:

"Kjo drejtori duhet të bashkëpunojë me drejtori të tjera sidomos me DSHI-në. Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për plotësimin me kuadro. Dhe drejtoria duhet të plotësohet me kuadro menjëherë."

A e shikoni këtë pjesë, Dëshmitar?

PË. Po. Por ju lutem në përgjithësi drejtoritë edhe në këtë kohë janë kanë jo të plotësume. Jo veç njana, dy a tri, por asnjana. Shtabi nuk arriti kurrë t'i plotëson të gjitha kapacitetet e nevojshme që është dashtë për këtë shtab. Kemi shku me atë ça kemi pasur, me ato ça kemi qenë në dispozicion, e kemi mujt të punojmë.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të pranohen në prova këto dy materiale.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka kundërshtime?

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim, të nderuar Gjykatës. Besoj që pjesë e kësaj game dokumentesh nga faqja 477 deri në 479 është pranuar tashmë si provë dhe ka numrin 1D00167.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Mund të pranohen pjesa tjetër

e faqeve në të njëjtin numër prove materiale në qoftë se kjo është më e përshtatshme.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti SPOE0022766468 [Sipas përkthimit], znj. Prokurore ju thoni deri në 6477, apo jo?

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Besoj që Avokatja po kërkonte që të pranoheshin në provë materiale vetëm dy faqe që përdori, ndërkohë që ajo që thashë unë është që tre faqe të tjera të të njëjtit dokument janë pranuar si prova.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa për të qenë më të qartë, do të japim, do të caktojmë dy numra të ndryshëm provash materiale për të gjitha faqet, pavarësisht që ato janë pjesë e të njëjtit dokument.

Pra, dokumenti SPOE00226468 pranohet si provë.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës. Sa për ta sqaruar, nëse e kuptova drejt, ju po pranoni faqet SPOE00226468, dhe SPOE00 --

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, vetëm thjesht caktoni një numër prove materiale për dokumentin e parë.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] E kuptova që do caktohen dy numra të ndryshëm prove materiale.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se e kam kuptuar siç duhet, ne kemi treguar dy faqe të dokumentit SPOE00226468, deri në SPOE00226480, që është

materiali i plotë. Dhe kemi treguar gjithashtu edhe faqen 68 dhe 70. Pyetja është, a duhet t'i japim numër prove të gjithë dokumentit, në të gjitha faqet, apo vetëm këtyre dy faqeve që paraqitëm më herët?

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ne po kërkojmë që t'i caktohet një numër prove vetëm këtyre dokumenteve, këtyre dy faqeve që unë përdora, dhe Gjykatësi tha që do përdoren dy numra të ndryshëm provash materiale, pavarësisht që janë pjesë e të njëjtit dokumenti më të gjatë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

[Trupi Gjykues dhe Sekretari i Gjykatës këshillohen]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Numri SPOE00226468 dhe SPOE00226470, si në anglisht ashtu dhe në shqip, do të pranohen me numrin -- më falni, do t'u caktohet numri i provës materiale 4D00068. Klasifikohen aktualisht si konfidenciale. Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

PY. Dëshiroj të kaloj tani tek drejtoritë e Shtabit të Përgjithshëm për të cilat folëm, z. Zyrapi.

Në pjesën 7, faqen 9 deri në 10 të intervistës tuaj të vitit 2019, keni thënë se drejtoritë e Shtabit të Përgjithshëm i raportonin në mbledhjet e Shtabit të Përgjithshëm zëvendëskomandantit Jakup Krasniqi dhe përmes tij komandantit të përgjithshëm. Ju kujtohet që keni thënë kështu?

PË. Po.
PY. A është e vërtetë që në ato pak mbledhje që Shtabi i Përgjithshëm ka zhvilluar me drejtoritë, raportimi ishte vetëm për strukturën e paplotë të drejtorive dhe kërkesa për personel, kështu?
PË. Pak takimet që kemi pas shtabit gjithnjë kanë qenë për çështjet e drejtorive, plotësimin e tyre, kërkesat logjistike, kërkesat financiare, të cilat -- problemet infrastrukturore. Për këto, drejtori, është e kjartë.
PY. Pra, pajtoheni me mua se nuk -- nuk funksionojnë mjaftueshëm për të dhënë raporte, për probleme të tjera?
PË. Po, ishin këto probleme në atë kohë, më së shumti.
PY. Z. Zyrapi, na keni thënë se keni punuar për përmirësimin e strukturës së UÇK-së, sepse kishit përvojën profesionale ushtarake. Këtu përfshihej edhe tek menaxhimi i drejtorive, apo jo?
PË. Po, saktë.
PY. Kjo do të thoshte, pra kërkonte marrjen e raportimeve për nivelin e gatishmërisë dhe funksionalitetit, dhe të ndërhyrjes në rast nevoje, kështu?
PË. Po.
PY. Në një ushtri të rregullt, z. Zyrapi, për ta thënë shumë thjesht, drejtoritë a do t’i -- drejtoritë do t’i raportonin shefit të shtabit, apo jo?
PË. Në, varet prej sistemit të organizimit. Kur i raportohet

vetëm shefit të shtabit, është në atë kohë kur sistemi i rregullimit, si për shembull tani, është vetëm shef shtabit, nuk ka komandant të përgjithshëm. Atëherë dhe raportohet shefit të shtabit drejtpërdrejti, të gjitha, ose zëvendësit të tij.

Kurse në këtë rast, ne nuk kemi pasë të tillë këtë organizim, por kemi pas organizim tjetër, domethënë, komandantin, zëvendësin, tek shefi i shtabit. Shefi i shtabit të gjitha i ka këto përgatitje, por raportimet gjithnjë i kanë shku, i raportojnë komandantit ose zëvendësit, në mbledhjet apo nevojat të cilat kërkohen.

PY. Në UÇK raportimi kishte më shumë një natyrë informale, jo siç do të ndodhte në një ushtri të zakonshme, apo jo?

PË. Po, informimi zakonisht në atë kohë ka qenë siç e ceka dhe më herët, si shifet dhe në mbajtjen e takimeve, gjithnjë me problemet e furnizimit, resurseve, të gjitha këto të cilat si nevojiten. Në fakt, vetëm normale, normalisht është, shkon përveç kësaj, duhet të jetë edhe aspekti i profesionalizimit të një drejtimi, drejtorive, kur them profesionalizimi është pjesë edhe e trajnimeve edhe aftësimeve edhe njësive më poshtë të këtyne sektorëve. Por ne nuk kemi arrit të gjitha këto t'i bëjmë, veç disa sektorë i kemi mujt t'ia arrisim, t'i përgatisim nji pjesë të këtyre drejtimeve, por të gjitha jo.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj që të nxirret në ekran dokumenti me numër P00621, ju lutem.

Të nderuar Gjykatës, dëshiroj që të themi për procesverbalin që vura -- që procesverbalin që është reflektuar si P2621 [Sipas përkthimit], por në fakt duhet shënuar P621, gjatë pyetjeve të z. Roberts është përmendur ky dokumenti.

PY. Jua ka treguar këtë dokument dje z. Roberts, a ju kujtohet, z. Zyrapi?

PË. Po.

PY. Dje na thatë se është një urdhër për mënyrën e raportimit para Shtabit të Përgjithshëm dhe në çfarë duhet të mbështetet ky raportim, kështu?

PË. Po.

PY. Kryeshefat e drejtorive udhëzohen me këtë urdhër që të përgatisin kontributet me shkrim për një listë çështjesh të referimit, kështu?

PË. Po, saktë.

PY. Dëshiroj që të përqendrohemi tek lista e çështjeve të referimit, është udhëheqja dhe komandimi, morali, aftësimi, logjistika, mbrojtja dhe siguria. Këto janë të gjitha çështje operative, apo jo?

PË. Të gjitha janë, përfshin veç operative, normalisht që operative në shumti përfshin këtë në këtë drejtim, por për të gjithë.

PY. Po të shohim pjesën e poshtme të dokumentit, vërejmë aty inicialet SV në të majtë. Mos bëhet fjalë për Sali Veselin?

PË. Po, po. Shumë saktë. Sali Veseli dhe është Shqipe Ahmeti. Të dy aty, inicialet, po.
PY. Po, të cilën e cekëm dje.
PË. Po, po. Është e saktë.
PY. Këto iniciale që janë këtu në të majtë, janë këtu në të majtë, SV, Sali Veseli, për arsye se ai e ka përpiluar këtë dokument?
PË. Po, çdo herë qiten inicialet ai kush e ka përpilu dokumentin.
PY. Dhe inicialet e dyta, mos vallë është personi i cili e ka përpiluar dokumentin? Shqipe Ahmeti. Ah, një person e përpilon, dhe tjetri e përgatit, në kuptimin që e shtyp? Kështu?
PË. Po, kjartë.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj që të nxjerrim në ekran dokumentin P01408, ju lutem.

PY. Ju rikujtohet që këtë dokument ju ua kanë treguar më datë 2 korrik, edhe dje pastaj sërish, z. Zyrapi, ju kujtohet?
PË. Po, e saktë.
PY. Këto janë shënimet e mbledhjes me drejtoritë më datë 29 dhjetor të vitit 1998, kështu është?
PË. Po. Po, saktë.
PY. Edhe një herë, është lista e pjesëmarrësve, dua t’jua sjell në vëmendje të, pra, në mbledhje morën pjesë Bislim Zyrapi, Adem Grabovci, Fatmir Limaj, Ramë Buja, Sali Veseli.

E konfirmoni që emri i Jakup Krasniqit nuk del këtu në listën e të pranishmëve në mbledhje, kështu?
PË. Po, saktë. Në këtë mbledhje nuk ka qenë.
PY. Mu poshtë kësaj, shënimet e mbledhjes thonë se:
"Mbledhja është drejtuar nga z. Bislim Zyrapi i cili foli për strukturën e udhëheqjes dhe komandimit."
Në, pra, ju e keni thirrur këtë mbledhje informale dhe e keni drejtuar atë për të diskutuar për karakteristikat e secilës drejtori, kështu është?
PË. Po, është fol -- po. Është thirr kjo mbledhje për të shpjeguar për punën e drejtorive, jo veç këtu, por këtu thuhet edhe organizimi edhe veprimi i drejtorive në zonat operative, domethënë më poshtë.
PY. Për t'ju udhëzuar ata se si të veprojnë dhe -- si të vepronin, dhe se çfarë pritej prej tyre, kështu?
PË. Po. Për çka pritet prej tyre dhe si ata duhet t'i ndihmojnë edhe sektorët më poshtë për t'i zhvilluar në njësi të zonave operative. Ky takim ka qenë në atë kohë.
PY. Dëshiroj që të kalojmë tani tek dëshmia juaj në lëndën Sainovic në TPNJ në nëntor të vitit 2006.
ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Për referencë, është me numër P1356, faqja 6268, rreshtat 1 deri në 4.
PY. Ju kujtohet që të keni dëshmuar në atë lëndë gjyqësore për rolin dhe funksionet e shefit të shtabit, z. Zyrapi?
PË. Po.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem, kalojmë në faqen -- të nxjerrim në ekran faqen 6268, ju lutem.

PY. Është një pasazh i shkurtër. Mund edhe t'jua lexoj ndërkohë. Ju është kërkuar që të përshkruani rolin e shefit të shtabit dhe dëshmia juaj është kështu:

"Funksioni i shefit të shtabit është që të drejtonte -- të drejtonte Shtabin e Përgjithshëm dhe drejtoritë brenda Shtabit të Përgjithshëm."

Është e saktë?

PË. Drejtoritë brenda Shtabit të Përgjithshëm.

PY. Do të kaloj tani tek emërimet, z. Zyrapi. A është e vërtetë se ishte e rëndësishme që të vendoseshin -- njerëzit më të mirë në postet e duhura, kështu?

PË. Po, saktë.

PY. Dhe kur keni vizituar shtabet lokale në pranverë dhe verë të vitit 1998, keni thënë në Pjesën 2, faqen 11 të intervistës suaj me ZPS-në të vitit 2019, se një prej detyrave tuaja më të para ishte që të bënit propozime për emërimet. Ju kujtohet kjo?

PË. Po.

PY. Kur u bëtë shef shtabi, vijuat që të siguronit që postet në nivel zone dhe nivel brigade të plotësoheshin, kështu?

PË. Po.

PY. Ju ka treguar dokumentin P1385, nga Prokuroria.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj që ta nxjerrim në ekran

këtë tani, ju lutem. Ju lutem, të kalojmë në pjesën e poshtme të faqes.

PY. E shihni këtu se deri më 11 korrik të vitit 1998, Sali Veseli ishte -- kryeshefi i operacionit, i shtabit operativ në Dukagjin, kështu?

PË. Po, kështu.

Kërkoj që të nxjerrim në ekran dokumentin me numër P1384, ju lutem.

PY. Për informacionin tuaj, z. Zyrapi, ky është një dokument i cili është printuar nga një kompjuter, nga ana e Prokurorisë. Thjesht që ta dini, për të kuptuar se nga është prejardhja e këtij dokumenti.

Tani, duke e parë këtë dokument, ju nuk mund ta dini se kush e ka përgatitur këtë dokument, apo jo?

PË. Po, nuk mund ta di, se është dokument i paplotësuar. As me [E pakuptueshme] protokoll, as protokoll, datën, as nënshkrimi, as kush e përpiloi.

PY. Nuk mund ta dini nëse ky dokument është printuar, nënshkruar, dhe dërguar në korrik të 1998, kështu është?

PË. Po, kështu është, edhe këtu kam [E pakuptueshme] këqyr edhe datën që është 24 i shtati, ne jemi kanë veç në luftime goxha ashpër në territorin e Rahovecit. Nuk kemi pas ne mundësi të shkrujmë këto dokumente, as të përgatisim këto dokumente të tilla. Personalisht po foli mua dhe anëtarët e shtabit që kam pas afër aty.

PY. Pra, thjesht duke e parë këtë dokument, nga pamja e tij, dhe në bazë të përgjigjes tuaj, do të ishte e saktë nëse do të thoshim që s'ka mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm në datë 24 korrik të 1998, me aq sa mund ta mbani mend ju?

PË. Mu, sa mbaj mend këto ditë kanë qenë ditë të luftimeve, takime s'kemi mujt me pas, mbledhje të mbajmë sikurse janë mujt me rend dite ose me raportu për të gjitha problemet.

PY. Dhe beteja e Llapushnikut ishte veç duke u zhvilluar, apo jo, asokohe?

PË. Jo, në atë kohë veç ka fillu te Llapushniki luftimet, po është e vërtetë se jemi mbartun unë edhe Rexha kemi shkue drejt në Llapushnik, për t'i ndihmuar atyne njësive atje. Edhe kemi qëndru në atë kohë. Tash a ka qenë 24, 25, nuk e di datat s'po më -- saktë me qenë, por këtë periudhë mbasi është ndërpre luftimet në Rahovec, kanë fillue në Llapushnik, pastaj kanë fillue në Drenicë, kanë fillue në vende të tjera. Kështu që çdo vend ku kanë fillue është dasht të shkojmë patjetër në atë drejtimin.

PY. Por, është e vërtetë besoj se po të shohim datën që sugjeron ky dokument, se është bërë mbledhja, është së paku dy javë pasi Sali Veseli tashmë e kishte filluar ushtrimin e detyrave të tij, në Dukagjin si shef i sektorit të operativës, kështu?

PË. Po, saktë. Unë e kam shpjegue edhe kur kam qenë vizitë në atë kohë në Dukagjin, ky ka qenë në këtë pozitë edhe me të kam

vizitue zonën e Dukagjinit. Në pozitën e kryeshefit të shtabit të zonës, faktikisht, nënzonës operative të asaj kohe.

PY. Nëse ju kam kuptuar saktë, këto emërime vinin nga zona, bëheshin nga zonat, dhe nëse kishte ndonjë zyrtarizim nga Shtabi i Përgjithshëm ishte thjesht një zyrtarizim të aspektit formal, kështu?

PË. Po, në atë kohë q'ashtu ka qenë.

PY. Deri në mes të nëntorit të 1998, drejtoria e personelit e drejtuar nga Adem Grabovci, ishte krijuar. Të paktën në letër, të themi, kështu?

PË. Po. Nga nëntori, ristrukturimi, ka filluar të formohet drejtoria e personelit në Shtabin e Përgjithshëm. Deri atëherë nuk kam pa.

PY. Keni përdorur fjalën "filloi", "kishte filluar". Pra ishte krijimi, fillimi i krijimit, nuk ishte funksionale asokohe, ishte një drejtori veç me një person, apo jo?

PË. Po, saktë. Unë e kam cek edhe e kam spjegu edhe ma herët. Që ka fillue drejtoria e personelit në nëntor, nji herë si nji person pastaj në varësisht prej tyre sa kanë arrit t'i ofrojnë afër vetes edhe ta formojnë këtë drejtori. Jo veç këto drejtori, por të gjitha drejtoritë.

PY. Emërimet në nivel brigade dhe nivel zone, asokohe, vijonin të bëheshin nga zonat. Flasim për periudhën e mesit të nëntorit, kështu?

PË. Po, është e saktë.

PY. Dhe a është e vërtetë se ishte e rëndësishme që duhet të kishin, duhet të kishe përvojë ushtarake, siç ju vetë, për të vlerësuar nëse një person ishte i përshtatshëm për të kryer disa, për të përmbushur disa poste të caktuara ushtarake?

PË. Po, është e saktë, për të vlerësuar në postet komanduese. Për të udhëheq një sektor aty, duhet të vlerësohet në aspektin, sidomos te ushtarakët, njësitë, domethënë, ushtarake, vlerësohet prej ushtarakëve, njerëz me përvojë, që a mund të udhëheqin ato, dhe a janë të gatshëm, a janë të aftë të udhëheqin atë sektor apo të komandojnë.

Z. MISETIC: [Përkthim] Duket se ka një gabim në përkthim në dokumentin në anglisht, nuk e di nëse ka vlerë apo jo. Por, në pjesën e sipërme, majtas, ka një fjalë në rreshtin -- në një nga rreshtat, më falni, e cila nuk është në origjinal.

Por, rreshti i tretë në pjesën e sipërme, duket se nuk është në origjinal.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

PY. Pasi Adem Grabovci u emërua në nëntor të 1998, roli i tij mos ishte për të marrë informacione dhe rekomandime nga zonat, të bashkërendonte me ju dhe pastaj t'ua dërgonte prapë këto zonave, kështu?

PË. Drejtoria e personelit, është edhe e cila i ka edhe resurset, burimet njerëzore, ajo normalisht që informacionet merren edhe nga zonat, merren edhe nga me ndihmat ushtarake

edhe nga shtabi, duhet marrë edhe nga drejtoritë e tjera, sidomos ma së shumti është dashtë të marrë edhe nga drejtoria e inteligjencës, për arsye se duhet me dit edhe aspektin kur të përcaktohet kush do detyrë komanduese a mund t'i ofrohet edhe t'i jipet ai besim. Është çdokund, edhe në paqe, edhe në luftë, që nga kjo drejtori kërkohen çdo herë. Thuhet, certifikimi ose i, a mund të ushtrojë atë detyrë. Mirëpo, të gjitha këto nuk kemi mujt t'i bëjmë në atë kohë, për arsye se edhe drejtoritë s'kanë qenë të plota, edhe nuk kanë pas resurset t'i kem të gjitha këto mundësi t'i bëjmë. Ato sa janë dhënë me ndihmat se çdo herë janë propozuar nga zonat, komandantët e zonave, ose brigadave, që të emërohen dikush në detyrat simbas vlerësimeve të tyre që i kanë pas. Te ne, në shtab, ne kemi mujt t'i vlerësojmë komandantët e brigadave dhe zonave që mund të vendosen në ato pozicione.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, vërej sa është ora. Do ta bëjmë tani pushimin prej dhjetë minutash?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta përdorni këtë kohë deri në orën 10.00.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj që të nxirret në ekran dokumenti 12005, ju lutem. Më duket se nuk ka përkthim në anglisht të këtij dokumenti, thjesht më duket vetëm versioni në shqip.

PY. Z. Zyrapi, shkoni në pjesën e sipërme majtas të këtij dokumenti, datën 13 dhjetor 1998?

PË. Po, e shikoj.
PY. Dokumenti duket se është një emërim me shkrim, nënshkruar nga komandanti i zonës së Dukagjinit, Ramush Haradinaj.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem, mund ta nxirrni pjesën e poshtme të dokumentit?

PY. Ku emërohet Maliq Ndrecaj, si komandant i brigadës 132, kështu?
PË. Po, simbas këtij dokumenti.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nëse mund të kemi tani dokumentin U000-351365 [Sipas përkthimit], ju lutem.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem, kërkoj që të thoni numrin.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] U000-3635. Ju lutem, të nxjerrim pjesën e poshtme të dokumentit që të duket nënshkrimi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani është koha për të bërë pushimin.

Z. Zyrapi, do t'ju japim dhjetë minuta pushim në këtë moment.

[Dëshmitar përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë këtu ndërprerjen e seancës për dhjetë minuta.

--- Pauza fillon në orën 10.02

--- Seanca fillon në orën 10.11

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem

silleni dëshmitarin në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të vazhdoni, znj. Alagendra.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Përpara se të bënim pushimin, z. Zyrapi, besoj se e patë dokumentin në ekran, është një dokument që mban datën 13 dhjetor, apo jo?

PË. Po.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të kalojë më poshtë në versionin në shqip të dokumentit.

PY. Ky është një dokument tjetër nga zona operative e Dukagjinit, është një dokument i cili mban datën 15 janar 1999, apo jo, Dëshmitar?

PË. Po.

PY. Në fund të faqes, tek pjesa e nënshkrimit, thuhet në fillim komandanti i Brigadës 132, Maliq Ndrecaj. E shikoni, e shikoni këtë, Dëshmitar? Edhe është edhe një nënshkrim aty, e shihni?

PË. Po, e shoh. Po e shoh.

PY. Nga ky dokument dhe nga dokumenti që ju treguam më herët që mbante datën 13 dhjetor duket sikur Maliq Ndrecaj është emëruar nga komandanti i zonës në dhjetor të 1998 dhe ishte duke ushtruar detyrat e veta në datën kur është bërë, kur është hartuar ky dokument, domethënë, më 15 janar 1999, a

është e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Po. Simbas dokumenteve po. Po në njohurinë teme, Maliq Ndrecaj nuk është që është emnu në nëntor. Ky ka qenë i emnum dhe i përcaktum qysh në korrik, qershor, korrik në 1998 kur janë formu brigadat e para në zonën e Dukagjinit.
Kështu që mund të jetën vetëm pas riorganizimit të sistemit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka mund me -- qe të bëhet ky urdhër përsëritës për vendosjen në pozita, kjo mund të jetë kjo.
ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do kërkoja tani të paraqitej në ekran prova materiale P1340. Nuk mendoj që është ky dokumenti i duhur. Mbase do jetë më mirë që të lexoj numrin ERN. Numri ERN është 00225268.
PY. Këtë dokument jua kanë treguar më datën 2 korrik, Dëshmitar, është dokument që jua ka treguar Prokuroria dhe dëshmia juaj është që juve nuk ju kujtohen që të jenë bërë këto emërime. A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?
PË. Po, saktë.
PY. Ky dokument mban datën 4 shkurt 1999, a është kështu?
PË. Po, me datë.
PY. Dëshmia juaj lidhur me këtë dokument është që këto emërime mund të jenë bërë nga drejtoria e kuadrove ose e personelit. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?
PË. Po.
ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë nga fundi

i faqes.
PY. Në të majtë të dokumentit në fund fare, shohim inicialet AG. Ky do ishte Adem Grabovci, besoj, apo jo, shefi i personelit, a është kështu, Dëshmitar?
PË. Po. Me iniciale Adem Grabovci shef i personelit ose drejtor i drejtorisë së personelit.
PY. Dhe mbështetur në atë çka keni thënë më herët në dëshminë tuaj, i takon që ky mund të jetë një dokument që është shtypur ose përgatitur nga dikush që ka inicialet AM, apo jo, Dëshmitar?
PË. Po.
PY. A ju ndihmon kjo për të kujtuar në qoftë se Ahmet Morina mund të ketë qenë personi që e ka ndihmuar Adem Grabovcin për të hartuar këtë dokument?
PË. Mund të jetë. Nuk muj po mu nuk më kujtohet, po mund të jetë.
PY. Në rregull. Tani të shohim pak përmbajtjen e këtij dokumenti, duket sikur ky dokument përfshinë dy persona në zonën e Dukagjinit, që është Daut Hilmi Haradinaj dhe Maliq Ndrecaj, a është e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Po, e saktë.
PY. Dhe Maliq Ndrecaj sipas këtij dokumenti emërohet komandant i brigadës 132, a është e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Saktë.
PY. Tek pika 4 e dokumentit thuhet:

"Këto emërime hyjnë në fuqi menjëherë".

E saktë është kjo, Dëshmitar?

PË. Po, e saktë.

PY. Por më 4 shkurt 1999, ti na e ke thënë më herët, që ju keni qenë, domethënë, ka pasur pozicione, këta persona kanë qenë në pozicione të tilla që prej nga korriku apo jo, e thatë më herët këtë? A është e saktë kjo, Dëshmitar?

PË. Po e saktë prej korrikut kur janë formu brigadat e para në këtë zonë dhe kur ka fillu kjo zonë të formohet në aspektet ushtarake, këto brigadat janë formu, 131, 132, 133 dhe këto dy kanë qenë veç komandantë në atë kohë.

PY. Pra, ky dokument që mban datën thuajse shtatë muaj pas kësaj periudhe, domethënë, pas korrikut, domethënë, i takon që është thjeshtë dokument shkresor për të pasur një dokument të shkruar për qëllime emërimi dhe nuk është asgjë tjetër përveç kësaj, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

PË. Po unë e shpjegova dhe më herët pak, që mund të ketë ato pas riorganizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, këto janë rishkruar dokumentet ose pozicionet të cilat kanë qenë vendosur komandantët e brigadave. Se është e vërtet që komandantët e zonave propozojnë komandantët e brigave për emnim dhe në Shtabit të Përgjithshëm emërohen. Ashtu është rregulla. Me siguri kjo është pas riorganizimit, ka ardhë kjo dhe është bë ky dokument pastaj është rishkruar prapë në vendimin që është vendos komandant si komandantë në këto dy

njësi.

PY. Më 3 korrik 2024, ti ke thënë në dëshminë tuaj, që emërime të tilla në nivel brigade bëheshin nga komandant i zonës, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

PË. Po. Komandanti i zonës ka bë në nivelin më poshtë pozicioneve. Kur folim për 1998, është e qartë që të gjitha pozicionet ato i kanë bë më parë zonat. Nuk ka pas të bën shtabi të emnon këto pozicione, se nuk ka qenë e rregullume deri sa nuk u bë riorganizimi.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] I lutem Sekretarit të paraqesë në ekran tani dokumentin që është provë e pranuar tashmë P01411.

Përpara sesa të kaloj tek ky dokument, të nderuar Gjykatës, kërkoj që dokumentet që sapo ia tregova dëshmitarit të pranohen si prova.

Më konkretisht, është dokumenti që fillon me 112005. Dokumenti tjetër është U000-3635. Këto dy dokumente. Ndërkohë që sa i takon dokumentit të tretë mendoj që e ka marrë një provë tashmë që është 1430.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka kundërshtime?

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime dhe mund të klasifikohen si dokumente publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti 112005 pranohet si provë. Ju lutem caktojini një numër prove.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e provës 4D00069 dhe do të klasifikohet aktualisht si konfidencial.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Caktojini një numër prove dokumentit 00225268 i cili pranohet si provë. Ju lutem caktojini një numër, Sekretar.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më lejoni që t'ia caktoj më vonë numrin këtij dokumenti.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Për procesverbal, i nderuar Gjykatës, besoj që nuk ka pasur përkthim në anglisht të dokumentit 112005, kështu që do të duhet që të përkthehet dokumenti në një ndër palët.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dhe dokumenti i dytë, të nderuar Gjykatës, është U000-3635 edhe këtë dokument e paraqesim për pranim si provë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka kundërshtim për pranimin e dokumentit 3635? Znj. Prokurore, ka ndonjë kundërshtim.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, jo nuk kemi kundërshtim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti U000-2635, pranohet.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

Gjykatës. Dokumenti U000-3635 deri në U000-3635 do të marrë numrin e provës 4D00070 dhe aktualisht është i klasifikuar si konfidencial.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të tre dokumentet mund të riklasifikohen si publik.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] I lutem Sekretarit të paraqesë në ekran provën P1411 tani.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj që është në ekran në fakt.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk është dokumenti që kemi në ekran. Është një dokument tjetër që po kërkoj të shfaqet. Ishte dokumenti që pamë pak më herët.

PY. Këtë dokument jua kanë treguar më datën 2 korrik, z. Zyrapi. A ju kujtohet ta keni parë më 2 korrik këtë dokument?

PË. Po.

PY. Më 1 korrik dëshmia juaj ishte që ju kishit ankesa ose kërkesa nga disa prej personave të zonave, domethënë, bëtë disa kërkesa për oficerë me përvojë nga zona e Dukagjinit për t'u bashkuar drejtorisë së operative, por vetëm Naim Maloku ishte personi që u përgjigj kërkesës tuaj. A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

PË. Po, saktë.

PY. Naim Maloku vazhdoi që të ishte anëtar i drejtorisë Operative tuajës në Divjakë, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

PË. Po.

PY. Në 2019, në intervistën e dhënë për Prokurorinë në Pjesën 11, faqja 10 i keni thënë Prokurorisë që Naim Maloku është transferuar në zonën e Dukagjinit pas një kërkese nga Ramush Haradinaj, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

PË. Po, e saktë.

PY. Naim Maloku është konsultuar dhe ai vetë ka dhënë pëlqimin që të lëvizte dhe të kthehej mbrapsht në zonën e Dukagjinit, a ka qenë kështu, Dëshmitar?

PË. Po, saktë.

PY. Dhe si shef i drejtorisë operative ju keni dhënë pëlqimin tuaj për këtë transferim, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

PË. Po. Po, e saktë.

PY. Dokumenti që shohim në ekran tani është një ushtrim tjetër për formalizimin e një vendimi të drejtorisë operative, ose një vendimi që ishte -- të një pëlqimi që ishte dhënë, domethënë, ndërmjet të tri personave në fjalë në këtë rast, domethënë, ndërmjet Ramush Haradinaj, Naim Malokut dhe juve, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

PË. Po, e saktë.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të kalojmë më poshtë në dokument tek pika 8.

PY. Tek pika 8 thuhet që:

"Për zbatimin e kësaj kujdesej drejtoria operative e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së."

A është e saktë kjo, Dëshmitar?
PË. Po, e saktë.
PY. Në fund të majtë të këtij dokumenti, jepen inicialet AG pastaj AM. Përsëri, për procesverbal, AG i referohet Adem Grabovcit, apo jo, Dëshmitar?
PË. Po.
PY. Ai ka qenë autori i këtij dokumenti si shef i drejtorisë së personelit, apo jo?
PË. Po.
ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] I lutem Sekretarit, që tani të paraqesë në ekran provën P1175. Kalojmë më poshtë në dokument.
PY. Z. Zyrapi, këtë dokument jua kanë treguar gjatë seancës përgatitore me Prokurorinë, a ju kujtohet kjo gjë, z. Zyrapi?
PË. Po.
PY. Në fund të dokumentit thuhet:
"Prishtinë, 19 nëntor 1998."
Shtabi i Përgjithshëm nuk ka qenë i stacionuar në Prishtinë në nëntor të 1998, apo jo, Dëshmitar?
PË. Po, saktë.
PY. Po ashtu javën që shkoi, juve ju ka pyetur z. Misetic për emërimin e z. Dobruna në nëntor të 1998 dhe ju thatë që vendimi për emërimin e z. Dobruna është bërë nga komandanti i përgjithshëm Azem Syla. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?
PË. Po.
PY. Një dokument i tillë, i kësaj natyre, në qoftë se është

nënshkruar nga z. Krasniqi është një dokument që thjesht ka formalizuar një vendim që në fakt ishte marrë më herët nga Shtabi i Përgjithshëm, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

PË. Po, e saktë.

[Trupit Gjykues dhe Sekretari i Gjykatës këshillohen]

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpresim, por Trupi Gjykues dëshiron që të shikojë gjithë përkthimin në anglisht. E kemi tani të shfaqur në ekran. Ju falenderojmë për këtë, Sekretar.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Mund të vazhdoj, të nderuar Gjykatës?

PY. Në seancën përgatitore, z. Zyrapi, ju kanë treguar tri dokumente të panënshkruara me emrin tuaj që duket se mbajnë një sërë emërimesh në nivel zone dhe brigade. Ju kujtohet?

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Për procesverbalin, janë me numër P00633, 635 dhe 637. Ju lutem, të nxjerrim në ekran dokumentin me numër 633.

PY. Siç e ceka më përpara, jua kanë treguar tri dokumentet. Ky është një prej tyre. Dhe në disa raste ju keni thënë se keni refuzuar t'i nënshkruani këto dokumente sepse emërimet në nivel zone apo në nivel brigade apo batalioni ishin në autoritet i komandantit të zonës dhe nuk bënte pjesë në përgjegjësitë tuaja. Thjesht për t'jua rikujtuar atë çka keni thënë lidhur me ketë. Apo jo?

Më datë 3 korrik, jua kanë treguar këtë dokument --

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po nuk kemi marrë përgjigje prej tij.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dhe kjo ishte një përmbledhje e paplotë gjithashtu.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjeni nga e para pyetjen në mënyrë tjetër dhe jepini kohë që të përgjigjet.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

PY. Pra, kur ju kanë treguar disa dokumente, njëri prej të cilëve është në ekran në këto momente, ju keni thënë se nuk keni pranuar që t'i nënshkruani këto dokument sepse emërimet brenda komandës së zonave apo në nivel brigade apo në nivel batalioni ishin kompetencë e komandantit të zonës dhe nuk bënte pjesë në përgjegjësitë tuaja, kështu është?

PY. Po, saktë, ashtu është.

PY. Ky dokument duket se përmban një sërë emërimesh në komandën e zonës së Pashtrikut në nivel brigade, kështu?

PË. Jo, ky dokument kur i shof këto emërimet janë krejt --

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem të shohim pjesën e poshtme.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të vazhdoni përgjigjen, Dëshmitar.

DËSHMITARI: Po. Ky është dokument të cilin janë dhënë të gjitha komplet komanda e zonës në pozicionet të gjitha

sektorëve. Këtë nuk e bën as shefi i shtabit, po as komandanti i përgjithshëm. Me rregull e kanë shpjeguar është shumë kjartë komandantin e zonës, zëvendëskomandantin propozohen nga zonat dhe mund të vendosë nalt komandanti i përgjithshëm. Dhe dihet procedurën sesi shkon përmes personelit, sikur që i pamë dhe dokumentet e mëhershme dhe propozimet. Kurse më poshtë i ka bë, i emnon vetë komandanti i zonës, si mbas punës dhe nevojës që ai ka.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të shikojmë pjesën e poshtme të faqes ju lutem, aty ku duhej të ishte nënshkrimi.

PY. Ju nuk e keni nënshkruar këtë dokument, apo jo?

PË. Po, saktë. Po, saktë nuk e kam nënshkru.

PY. Dëshmia juaj për këtë, z. Zyrapi, është se komandantët e batalioneve dhe oficerët brenda zonave nuk emëroheshin nga komandanti apo shefi i Shtabit të Përgjithshëm. Por emëroheshin nga komandantët e zonave, është e saktë kjo?

PË. Po, e saktë dhe e shpjegova më parë.

PY. Dhe emërimet në nivel zone dhe brigade binin jashtë rolit dhe përgjegjësive të komandantit të Shtabit të Përgjithshëm përfshirë këtu dhe zëvendëskomandantët. Pajtoheni me mua për këtë?

PË. Jo, zëvendëskomandantët janë propozu nga të zonave, mendoj të zonave, janë propozuar nga komandantët e zonave, janë emnuar në shtab. Është e kjartë ajo punë. Unë dhe e shpjegova mirë ato. Kurse të tjerët nuk propozohen as nuk

emërohen nalt në shtab. I emnon komandanti i zonës si mbas nevojës dhe detyrës përgjegjësive që i kanë. Ashtu ka qenë rregulla dhe ashtu është punu.

PY. Faleminderit. Nga nëntori i vitit 1998, një pjesë e rolit tuaj si shef i operativës dhe shef i shtabit, ju vijuat të punonit me komandantët e zonave për të përmirësuar organizimin në nivel zone, kështu?

PË. Po.

PY. Dhe kur u bëtë shef shtabi në nëntor të 1998-s në ristrukturimin e Shtabit të Përgjithshëm, ju kontaktuat, pra, kontaktet me komandantët e zonave u bënë më të shpeshta, apo jo?

PË. Po, mund të thuhet më të shpeshta jo dhe aq të shpeshta, mvarësisht prej situatave që kemi pasun. Marr atë që komandantë kemi takuar tri herë apo katër herë krejt në këtë periudhë.

PY. Dhe kur jua lejonin rrethanat, ju u keni dhënë urdhra zonave që të vinin në Divjakë për takime dhe që të raportonin, kështu?

PË. Do të duhen të jenë bë thirrjet që të vijnë në shtab që të raportojnë, jo urdhra.

PY. Po.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem të nxjerrim në ekran dokumentin me numër P615.

Ju lutem të kalojmë në pjesën e poshtme në mënyrë që

dëshmitari të shoh mirë të gjithë dokumentin.

PY. Në seancën përgatitore, ju keni konfirmuar saktësinë e këtij dokumenti, z. Zyrapi. Ju kujtohet kjo?

PË. Po.

PY. Dokumenti që kemi përpara nuk është i nënshkruar dhe për informacionin tuaj është një dokument i cili është printuar nga kompjuteri që Prokuroria thotë se e ka sekuestruar. A jua kanë treguar këtë në momentin kur ju kanë bërë pyetje lidhur me këtë dokument?

PË. Po.

PY. Pyetja që kam unë është kjo: Në momentin kur Prokuroria jua ka treguar këtë dokument gjatë seancës përgatitore, a ju kanë informuar se ky dokument është printuar nga një kompjuter i sekuestruar prej Jakup Krasniqit? A jua kanë informuar këtë fakt gjatë seancës përgatitore?

PË. Po, që është i marrë nga Jakup Krasniqi.

PY. Jo, nuk është pyetja a ia kanë marrë apo jo, Jakup Krasniqit. Por Prokuroria a ju ka informuar apo jo, kur jua treguan këtë dokument gjatë seancës përgatitore se është printuar nga një kompjuter?

PË. Nuk më kujtohet, po e di është spekuluar që ku është marrë.

PY. A ju kanë treguar ndonjë kopje të nënshkruar të këtij dokumenti, z. Zyrapi?

PË. Mirëpo këto shumë dokumente më janë treguar, po tash

s'muj t'i mbaj mend të gjithë dokumentet.

PY. Sipas këtij dokumenti keni instruktuar komandantët e zonave për të përgatitur një sërë raportesh për një sërë problemesh, përfshirë këtu udhëheqjen dhe komandimin moralin aftësimin, mobilizimin, logjistikën, mbrojtjen dhe sigurinë dhe gjendjen luftarake në zonat operative, përfshirë këtu një analizë të forcave të armikut, forcave të UÇK-së dhe bashkërendimin me zonat e tjera. E shihni këtë në dokument?

PË. Po.

PY. Dhe në pikën 7 të dokumentit, duket se komandanti i zonës informohet se pas kryerjes së referimit do të vijë një urdhëresë me shkrim për veprime luftarake. E shihni?

PË. Po.

PY. Në fund majtas të dokumentit, pjesën e poshtme majtas inicialet SV janë të dukshme. Është e vërtetë që e ka hartuar Sali Veseli këtë dokument, z. Zyrapi?

PË. Po.

PY. Po inicialet VG të kujt janë e dini?

PË. Për momentin mu s'më kujtohen fare.

PY. Mirë. Por besoj se është e vërtetë që aso kohe komandantët e zonave jo gjithmonë mund të merrnin pjesë në këto mbledhje për shkak të situatës në terren?

PË. Po, e saktë është.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Mund të kalojmë në seancë private, të nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi kthyer në seancë publike. Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të vazhdoni.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj të kemi në ekran dokumentin P228, ju lutem. Mund të shohim pjesën e poshtme të dokumentit, ju lutem. Të faqes së fundit, ju lutem, për nënshkrimin.

PY. Ju rikujtohet ky dokument, z. Zyrapi?

PË. Po, plotësisht.

PY. Është e vërtetë se është një raport i nënshkruar nga ju në bazë të referimeve që keni marrë nga komandantët e zonave?

PË. Po. Kjo është një përmbledhje e raporteve të cilët i kanë dorëzuar komandantët e zonave dhe kjo përmbledhje i është dërguar zëvendëskomandantit.

PY. Po. Le ta shohim këtë dokument. Siç e shihni është i ndarë sipas temave, udhëheqja dhe komanda.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në pjesën e parë të dokumentit. Ta vëmë dokumentin nga e para, ju lutem. Të fillojmë me faqen e parë, ju lutem.

PY. Pra, siç e shohim ky është i ndarë sipas temave, z. Zyrapi, apo jo? Tema e parë është udhëheqja dhe komandimi, apo jo?

PË. Po, e saktë është.

PY. Pastaj vjen morali luftarak.

PË. Po, kjartë.
PY. Pastaj kalon tek aftësimi, mobilizimi dhe çështje të personelit, logjistikës. Pastaj kalon tek mbrojtja, siguria, situata luftarake dhe kemi propozime për përdorimin e njësive taktike dhe operative për aktivitete luftarake dhe kërkesë nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, kështu?
PË. Po, saktë.
PY. Dhe është e vërtetë, z. Zyrapi, se temat që ne shohim këtu, bënin pjesë në rolet dhe përgjegjësitë e drejtorisë operative të Shtabit të Përgjithshëm, kështu?
PË. Këto bëjnë pjesë në përgjithësi dhe rolet e të gjithëve. Është marrë si raport të cilin e raportojnë komandantët për gjendjen në zonat e veta dhe kjo është dhe në përgjithësi nuk është veç e drejtorisë operative.
Kur t'i marr me këqyr të gjitha këto detyrat ose që janë dhënë që ata raportojnë, raportojnë për krejt jo veç për operacionet ose për përgatitjet operacionale, po kjo edhe e logjistikës, e personelit edhe financave edhe të gjithëve, domethënë, në përgjithësi është.
PY. Nëse mund të bëj një përmbledhje të përmbajtjes së këtij raporti, aty përshkruhet mungesa e komandimit të duhur, kështu?
PË. Po, saktë është.
PY. Mungesë e komunikimeve dhe e pajisjeve, kështu?
PË. Po, saktë është.

PY. Ka poste të paplotësuara me njerëz në nivel të zonave, kështu?

PË. Po, saktë është. Bile tash folëm she shumë çështje të tjera për këto probleme dhe të plotësimit të personelit, resurseve tjera.

PY. Dhe kjo përfshinte dhe moralin e ushtarëve, përmirësimin e aftësimit dhe gatishmërisë, mungesën e armatimeve dhe armëve të duhura, fronti i mbrojtjes, probleme në këto dhe probleme sa i takon numrit të forcave dhe lëvizjeve të armikut në raport me forcat e UÇK-së, kështu?

PË. Po, kjartë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Avokate është momenti për të bërë pushimin e paradites.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nëse mund ta përfundoj fjalinë e fundit me dëshmitarin?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

PY. Të gjitha këto, z. Zyrapi, ishin probleme të cilat kërkonin një farë njohurie të taktikave ushtarake. Apo jo? Këto që sapo jua përmenda.

PY. Të gjitha këto janë probleme jo veç taktike-ushtarake, po dhe tjera edhe financiare, logjistike e të gjitha i prefshin. Po ne jemi tuj fol për konkretisht njësi ushtarake janë këto, po të gjitha janë njëjtë, përfshihen të gjitha problemet këtu. Jo veç në këtë raport që është bë, por çdo herë raporte që

kanë ardh kemi pas probleme të tilla. Se nuk kanë qenë të plotësuara as me resurse si ato teknike ashtu njerëzore që të është e plotë edhe për t'i kry ato problemet ose për të ec përpara. Kaq.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dëshmitar, tani është momenti për të bërë pushimin e paradites. Ky pushim zgjat gjysëm ore.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë besoj se për këtë dëshmitar seanca mbaron tani.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, ndjesë. [Mikrofoni çaktivizuar]. Besoj tani do ju bëhet qejfi, jo nuk do riktheheni mbas gjysmë ore. Do të rishihemi bashkë ditën e hënë. Faleminderit deri tani. Kalofshi mirë fundjavën.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Alagendra, ju lutem na thoni sa mendoni ju kanë mbetur kohë për pyetjet?

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Besoj se edhe dy orë të tjera, dy orë e gjysëm të tjera.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, në rregull.

Bëjmë këtu ndërprerjen e seancës deri në orën 9.00 të hënën.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, për sot kemi. Për javës

tjetër nuk kemi dëshmitar të dytë. Për sot e kemi një dëshmitar tjerë. Ndjesë për ngatërrimin.

--- Pauza fillon në orën 11.04

--- Seanca rifillon në orën 11.32

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se jemi në seancë private apo jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

Do kalojmë në seancë private.

Ju lutem, Sekretar, na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do e përsëris për qëllime të seancës publike. Tani do të vazhdojmë me dëshmitarin e Prokurorisë 04501. Dëshmitari do japë dëshmi përmes videolidhjes. Sikurse mund ta shikoni, janë marrë masat e duhura logjistike.

Znj. Sekretare, mund ta sillni dëshmitarin në ambientin ku jeni.

[Dëshmitari paraqitet përmes videolidhjes]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për procesverbal në vendin në distancë të pranishëm janë dëshmitari 04501 dhe unë, Sekretare Gjykate.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit shumë, znj. Sekretare.

Mirëmëngjes, Dëshmitar. Dëgjoni, Dëshmitar? Mirëmëngjes.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, mirëmëngjes.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në vendin ku gjendeni, stafi i NJAGJ-së do t'ju japë tekstin e betimit solemn që duhet ta lexoni. Ju lutemi, hidhni një sy njëherë dhe pastaj lexojeni me zë tekstin e betimit solemn, Dëshmitar.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Mirë. Në rregull.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, lexojeni me zë, Dëshmitar.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] I përgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: W04501

[Dëshmitari dëshmon përmes videolidhjes]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar. Tani mund të uleni.

Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj. Dëshmia juaj planifikohet që të zgjasë përafërsisht tre orë e gjysmë. Sikurse dhe mund ta dini, së pari do t'ju bëjë pyetje Prokurori. Pasi të përfundojë Prokuroria, do t'ju bëjë pyetje Avokati i Viktimave, po ashtu edhe ekipet e Mbrojtjes kanë të drejtë që t'ju bëjnë pyetje. Përveç kësaj edhe anëtarë të Trupit Gjykues mund t'ju bëjnë pyetje, Dëshmitar.

Prokuroria ka vlerësuar se i duhet një orë për t'ju marrë në pyetje. Ndërkohë, Mbrojtësi i Viktimave do t'ju bëjë pyetje për rreth 15 minuta. Vlerësimet e ekipeve të Mbrojtjes janë që do t'u duhen rreth dy orë për t'ju bërë pyetje. Si në çdo rast tjetër, vlerësojmë dhe shpresojmë që ekipet të jenë, ta përdorin kohën në mënyrë efikase. Trupi Gjykues do të lejojë pyetje plotësuese në qoftë se përmbushen kriteret për këtë

gjë.

Dëshmitar, të lutem, dëgjojini pyetjet dhe jepni përgjigje pyetjeve në mënyrë të shkurtër dhe të qartë. Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen, lirisht mund t'i tregoni Avokatëve ose atyre personave që do t'ju bëjnë pyetje që t'jua shpjegojnë më tej pyetjen. Po ashtu, ju lutem, thoni rrethanat dhe bazën e njohurive të përgjigjeve që do jepni.

Po ashtu, kur Prokuroria t'ju pyesë për të bërë korrigjime për deklaratat e mëhershme, ju kujtojmë që të thoni për procesverbal që dëshmitë tuaja së bashku me korrigjimet e mëvonshme nga juve, pasqyrojnë në mënyrë të saktë dëshminë tuaj. Ju lutem flisni pranë mikrofonit, bëni një pauzë prej pesë sekondash përpara se sa të jepni një përgjigje për pyetjen, dhe flisni ngadalë në mënyrë të tillë që t'ju kapin përkthyesit.

Gjatë ditëve që do të jepni dëshmi përpara Trupit Gjykues, nuk lejoheni që të diskutoni me askënd lidhur me përmbajtjen e dëshmisë tuaj jashtë kësaj salle gjyqi. Në qoftë se ndonjë person ju qaset për t'ju bërë pyetje lidhur me dëshminë përpara Trupit Gjykues, ju lutem na e thoni këtë gjë.

Ju lutem, pushoni së foluri në qoftë se ju kërkoj që të mos flisni më, dhe në qoftë se do ngre dorën, në qoftë se më shikoni që e ngre dorën, mos flisni më pasi kjo do të thotë që mua do më duhet që t'ju jap udhëzime të tjera.

Nëse e ndieni të nevojshme që të bëni pushime, ju lutem

na e thoni këtë gjë dhe ne do bëjmë organizimet e nevojshme.

Tani, do fillojmë me pyetjet nga Prokuroria, kështu që dëgjojeni me vëmendje Prokurorinë, Dëshmitar.

Znj. Prokurore, e keni ju fjalën.

ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

Pyetje nga znj. Iodice:

ZNJ. IODICE: [Përkthim]

PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Unë quhem Vega Iodice dhe sot do t'ju bëj pyetje në emër të ZPS-së. Sikurse e kam shpjeguar gjatë takimit të fundit që kemi pasur bashkë, në vend që t'ju bëj pyetje për çdo temë ose çdo çështje për të cilën mund të keni informacion, është e mundur që të pranohen disa prej deklaratave të mëparshme të dhëna prej jush në prova. Megjithatë do të duhet që të ndiqen disa hapa proceduralë për ta bërë këtë gjë. Përpara se sa të cek këto hapa proceduralë, së pari dua që t'ju pyes për emrin dhe mbiemrin, por përpara kësaj do të doja t'i kërkoja Gjykatësit që të na kalojë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për mbrojtjen e dëshmitarit, do i kërkoj Sekretarit të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të vazhdoni, Prokurore.

ZNJ. IODICE: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, keni dhënë dëshmi në të shkuarën, përfshirë këtu edhe dëshmi për ZPS-në dhe ju është dhënë mundësia që të rishikoni deklaratat në seancën përgatitore me Prokurorinë.

Sot do të kërkojmë që të pranohen në prova deklaratat e dhëna më herët prej jush.

ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që të paraqesë në ekran dokumentin 068515-TR-ET, Pjesa 1, RED2, nuk është për t'u paraqitur për publikun, dhe kërkoj që përveç këtij dokumenti të paraqitet dhe dokumenti në shqip i të njëjtit materiali.

PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që jeni marrë në intervistë nga Prokuroria në vitin 2019?

PË. Po.

PY. A ju kujtohet që e keni lexuar këtë deklaratë në gjuhën tuaj, domethënë në shqip, dy javë më përpara?

PË. Po.

PY. A ju kujtohet se ju është dhënë mundësia që të bëni korrigjime dhe sqarime në deklaratën tuaj?

PË. Po.

PY. A ju kujtohet që këto korrigjime janë shkruar në një shënim, shënim i cili më pas ju është lexuar ju?

PË. Po.

PY. A konfirmoni se ajo çfarë ju është lexuar në atë shënim pasqyron ndryshimet plotësisht dhe në mënyrë të saktë, ndryshimet që keni bërë ju, Dëshmitar?

PË. Po.

PY. Në qoftë se përfshijmë të gjithë korrigjimet dhe sqarimet që keni bërë, informacioni që jepet në deklaratën tuaj, a

është i saktë dhe a është i vërtetë me aq sa dini ju, Dëshmitar?

PË. Po. Çka kam dhanë në deklaratë janë deklaratat e mia. Edhe nuk është deklarata ime e parë të cilën e kam dhanë.

PY. Po --

PË. Edhe --

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të vazhdoni, Dëshmitar.

DËSHMITARI: Edhe nji. Nuk kam dhanë unë deklaratë e cila ka mujt me qenë e kundërligjshme apo që më ka shty mu dikush, as nuk jam ardh unë tek ju që më keni thirr ju. Unë kam ardh me, në bazë në atë kuptimin që deri kam gjet që ku duhet me ardh për me gjet nji vend për me dëshmu. Kjo --

PY. Faleminderit për këtë sqarim --

PË. -- është nji -- kjo është njëra nga deklaratat e 2019, për shembull. Deklarata për --

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar.

[Folës që flasin njëkohësisht]

Tani për momentin thjesht dëgjoni pyetjen, dhe jepini përgjigje pyetjes që do ju bëhet.

ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Faleminderit, Dëshmitar. Tani, po i kthehem dhe një herë pyetjes që ju bëra pak më herët. Informacioni në deklaratën që keni dhënë në 2019, plus sqarimet dhe korrigjimet që keni bërë

dy javë më përpara, a është i saktë dhe i besueshëm me aq sa dini dhe besoni ju?

PË. Unë ça kam dhanë deklaratë, mbes mbas deklaratës teme në atë kuptimin ligjor edhe njerëzor.

PY. Faleminderit. Nëse do t'ju bëheshin të njëjtat pyetje sot për të njëjtat ngjarje, a do të jepnit të njëjtat përgjigje ju, Dëshmitar?

PË. Ndoshta tash me emocione pak ma të mëdhaja, mirëpo të njëjtën.

PY. Faleminderit.

ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pasi kam përmbushur kriteret e Rregullës 154, dhe në përputhje me vendimin F02415, paragrafi 19(a) ne kërkojmë që të paraqiten, të pranohen si prova dokumentet 068516-TR-ET, Pjesa 1, deri në pjesën 4 RED2, dhe përkthimi në shqip, i Rishikuar RED2, së bashku me Shënimin Përgatitor që mban numrin ERN 121914 deri në 121921.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë kundërshtim?

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime të tjera përveç atyre të cilat janë paraqitur në parashtrimet me shkrim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk dëgjojmë kundërshtim tjetër, dokumenti 068516-TR-ET, Pjesa 1, deri në 4 RED2, plus përkthimin në shqip, dhe Shënimi

Përgatitor me numër ERN-je 121914 deri në 121921, pranohen si prova.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Deklaratat, domethënë Pjesa 1 e deklaratës që është 068516-TR-ET, Pjesa 1, RED2 si në shqip dhe në anglisht do të marrë numrin e provës P01441.1, dhe aktualisht është klasifikuar si konfidenciale.

Për Pjesën 2 me të njëjtën ERN, numri i provës do jetë P10441.2 [Sipas përkthimit], si për versionin shqip dhe në versionin në anglisht, dhe do jenë të klasifikuar si konfidencialë.

Për Pjesën 3 të dokumentit me të njëjtin ERN, prova, numri i provës që do të caktohet është P01441.3, dhe do jetë i klasifikuar si konfidencial.

Dhe për Pjesën 4 të dokumentit me të njëjtin numër ERN-je si në versionin në shqip dhe atë në anglisht, do të caktohet prova P01441.4, dhe klasifikimi aktual është konfidencial.

Sa i takon Shënimi përgatitor numër 1 që ka numrin 121941 [Sipas përkthimit] deri në 121921, ky dokument do të marrë numrin e provës materiale P01441.2, dhe aktualisht është dokument i klasifikuar si konfidencial.

Ju falënderoj, të nderuar Gjykatës.

ZNJ. IODICE: [Përkthim] Janë dhe tri prova të lidhura, ose shoqëruese, që kërkojmë që të pranohen si provë materiale,

që kanë aktualisht numrin ERN 068510 deri në 068512, dhe sërish kërkojmë që ky material të paraqitet, të pranohet në prova.

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Dokumenti me ERN 068510 deri në 068512 pranohet si provë. Ju lutem, caktojini një numër prove, Sekretar.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës. Ju lutem, a mund të sqaroni në qoftë se bëjmë fjalë për tre skica të ndryshme? Domethënë, në këtë rast, mjafton një numër prove apo duhet të caktoj tre numra të ndryshëm prove?

ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, mjafton një numër prove, dhe klasifikimi duhet të jetë konfidencial.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit. Atëherë, dokumenti 068510 deri në 068512 do të marrë numrin e provës P01443, dhe do klasifikohet si konfidencial. Ju faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Vazhdoni.

ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit. Të nderuar Gjykatës, në qoftë se më lejoni dua që të lexoj një përmbledhje të shkurtër publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në vitin 1998, dëshmitari 04501 u

arrestua nga ushtarët e UÇK-së dhe u dërgua në shtabin e UÇK-së. Përveç tij, u arrestuan edhe të afërm të tij të tjerë.

Dëshmitari 04501 është ndaluar dhe ka dëgjuar tingujt e rrahjeve, zhurmat e rrahjeve që vinin nga jashtë dhomës së tij.

Dëshmitari 04501 është marrë në pyetje nga anëtarët e UÇK-së përpara se sa të lirohej.

Të nderuar Gjykatës, pyetjet plotësuese përfshijnë informacione të cilat mund të identifikojnë dëshmitarin, kështu që për këtë arsye kërkoj që të kalojmë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, na kaloni në seancë private, Sekretar.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, jemi përsëri në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë pushim deri në orën 14.30

--- Pauza e drekës fillon në orën 12.55

--- Seanca rifillon në orën 14.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Mund të sillni dëshmitarin tani në sallë.

Z. TULLY: [Përkthim] Shumë shkurt, nëse mundem.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

Z. TULLY: [Përkthim] Sa për të sqaruar.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, vazhdoni.

Z. TULLY: [Përkthim] Thjesht për qartësi të procesverbalit, në faqen 72 të transkriptit sot, kishte të bënte me provën P00709. Mund të jetë gabim, por këtu shkruhet sikur i keni thënë që:

"Dokumenti është i mjaftueshëm sipas rregullës 154 dhe 138. Nuk është deklaratë."

Ma merr mendja se ai pranohet vetëm sipas rregullës 138 dhe jo edhe sipas rregullës 154.

[Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

Z. MISETIC: [Përkthim] Përgjigja juaj nuk doli në transkript.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

Z. MISETIC: [Nuk ka përkthim]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do të vazhdojmë tani me pyetjet nga Avokatët e Mbrojtjes. Do të fillojmë me ekipin mbrojtës të z. Thaçi.

Znj. Menegon, keni fjalën.

ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Faleminderit. Për të mbrojtur dëshmitarin, kërkoj që të kalojmë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në

seancë private, ju lutem.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

v[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

Këto pyetje janë për Mbrojtjen gjithashtu të z. Krasniqi, por mund mos t'u përgjigjeni sot, thjesht mund të mendoni për to gjatë fundjavës, dhe do t'ju kërkoj që t'u përgjigjeni të hënën.

Dy gjëra kanë dalë gjatë kundërpyetjeve që u janë bërë z. Zyrapi. Pikësëpari duket se një sërë dokumentesh duket se -- kemi parë, pra, se një sërë dokumentesh që duket se mbajnë nënshkrimin e z. Jakup Krasniqi. Duket se Mbrojtja e Krasniqit kundërshton origjinalitetin e nënshkrimit në disa prej dokumenteve, por nuk kundërshton autenticitetin e nënshkrimit të z. Krasniqi në dokumente të tjera. A e kam kuptuar qartë qëndrimin tuaj apo jo? Dhe, nëse e kam kuptuar qartë, pra nëse është kështu, ku qëndron dallimi midis nënshkrimit që duket se është i z. Krasniqi, autenticiteti i të cilit kundërshtohet, nga nënshkrimet autenticitetin e të cilave ju nuk e kundërshtoni. Siç e thashë, s'është nevoja që t'i përgjigjeni tani.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Patjetër, do t'u përgjigjem unë këtyre pyetjeve ditën e hënë.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

Pika e dytë ka të bëjë me përgjimet e komunikimit. Do të flas në mënyrë të përgjithshme, në mënyrë që të vazhdojmë të jemi në seancë publike. Duket se ju në përgjithësi kundërshtoni autenticitetin e këtyre përgjimeve, por nga ana tjetër gjithashtu mbështeteni në të paktën një prej këtyre përgjimeve për të nxjerrë të vërtetën e pikave të cilat diskutojmë në bisedën e përgjuar.

Pyetja që kam, kjo: A e kam kuptuar qartë qëndrimin tuaj dhe nëse po, a pajtoheni dhe ju se së paku disa prej përgjimeve janë dokumentacion i besueshëm si bisedë bazë?

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do t'u përgjigjem ditën e hënë. E doni me shkrim?

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Si të dëshironi. Gojarisht apo me shkrim.

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Patjetër.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka gjë tjetër, atëherë bëjmë ndërprerjen e seancave, seancës, deri ditën e hënë në orën 9.00.

--- Seanca mbyllet në orën 15.45